



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-119

Prishtinë, më 8 korrik 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 KORRIK 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 27 qershor dhe me 1 korrik 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 27 qershor dhe me 1 korrik 2013

Kryesia i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 27 qershor dhe më 1 korrik 2013, me vërejtjet e nënkryetarit të Kuvendit, z. Sabri Hamiti, në procesverbalin e datës 1 korrik 2013, të mbajtur në orën 11:00, dhe në orën 15:00, lidhur me deklarinimin e tij për mosrespektim të kushteve dhe të afateve procedurale për shqyrtimin e parë të projektligjeve për seancën plenare më 4 korrik 2013.

Njëherësh, edhe kryetari i GP të SLS, Sasha Milosavleviq, bëri vërejtje në procesverbalin e datës 27 qershor 2013 lidhur me korrigjimin e emrit të tij në vend të deputetit Milivoje Stojanoviq.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin për mbajtjen e seancave plenare, me shumicë votash, përkatësisht me dy vota kundër (nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”), vendosi si në vijim:

I. Mbledhja plenare më 11 korrik 2013, do të mbahet, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë.

II. Mbledhja plenare më 11 korrik 2013, do të mbahet, në orën 15:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar,
10. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e deputetit Kurtan Kajtazi, mbështetur nga deputetët nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, i Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit

Kryesia, pasi diskutoi për çështjen e lartshënuar, këtë pikë të rendit të ditës e shtyu për vendim-marrje në mbledhjen e radhës të Kryesisë.

2. Procedimi i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Projektligji për fshatin Zym i Hasit t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor që ta shqyrtojë Projektligjin për fshatin Zymi i Hasit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin para shqyrtimit të parë.

3. Iniciativa qytetare për fillimin e nismës ligjore për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit

Kryesia u njoftua lidhur me iniciativën qytetare për fillimin e nismës ligjore për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit.

5. Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2012, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kryesia u njoftua me konstatimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për vlerësimin e shkëlqyeshëm të performansës lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Ndërkaq, rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për themelimin e Njesisë për auditimin e institucioneve të pavarura, të themeluara nga Kuvendi, e që sipas Ligjit mbi auditimin e brendshëm nuk i plotësojnë kushtet për të pasur auditor të brendshëm, Kryesia e shtyu për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

5. Informatë për gjendjen në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Kryesia, çështjen e lartcekur e shtyu përsëri për mbledhjen e radhës, me qëllim të analizimit të raportit të Komisionit për konstatimin e gjendjes në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi dhe përgatitjes së një rekomandimi për mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*